

AKT THEMELIMI

Sot ne dt. 02 Nëntor 2023 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",

AUREL LLAZI, i biri i AGIM i datelindjes 14/12/1990, i lindur ne Lushnje dhe banues ne Lushnje, lagj. Loni Dharmo, Rruga e Palmave, Pallati tre kollonat, Apart.9, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr. 034456529 leshuar nga MB Tirane me date 11/07/2019. te cilet me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **ROI & JORI** shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezqjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **ROI & JORI** shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortakut themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria **ROI & JORI** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"). Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj. Shoqëria **ROI & JORI** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakut i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen:

Autostrada Fier-Lushnje, 600 m nga kryqezimi i Pushimit te Shoferit Lushnje, zona kadastrale Nr.2286, volumi 8, faqe 59, pasuria nr 73/25.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

- **Dhenia me qira e pronësisë intelektuale dhe produkteve të ngjashme**

Neni 5

Kohezqjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar



Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 1000 leke i perbere nga 1 kuotë dhe zoterohet nga ortakut i shoqerise si me poshte :

1. Ortaku Themelues: **AUREL LLAZI**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 1000 Leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise
Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar **1000 Leke**

Vlera Totale e Kapitalit te Paguar **1000 Leke**, do te paguhet ne avance nga ortakut.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakut pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te tretteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem, i cili do te jete **AUREL LLAZI**, i biri i AGIM i datelindjes 14/12/1990, i lindur ne Lushnje dhe banues ne Lushnje, lagj. Loni Dharmo, Rruga e Palmave, Pallati tre kollonat, Apart.9, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.034456529 leshuar nga MB Tirane me date 11/07/2019.

Emerimi i administratorit eshte me nje afat pese vjeçar me te drejte rimerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta



injonin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktojnë në çfarëdo formë qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërise në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shpërndarja ose prishja e shoqërise mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar siç mund të jehet

a. Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhimit të metejshëm të veprimtarisë së saj.

b. Në një nga menyrat e parashikuara nga ligji "Për Falimentimin"

c. Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këtë rast Asambleja e Ortakut të vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyrën e likuidimit të shoqërise, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë "Shoqëri në likuidim e siper".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil, Ligji për QKB, dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në tre ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën italiane dhe pasi miratohet në parim dhe nënën nga Ortaku i vetëm themelues i shoqërise tregtare **ROI & JORI** shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

ORTAKËT SHOQËRISE

Aurel Llazi

